



## STATUS RAPORT MBI FINANCAT E VETËQEVERISJES VENDORE NË VITIN 2016

*NGA VIJNË DHE SI PËRDOREN FONDET PUBLIKE NGA BASHKITË E REJA?*

[www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al)



Tiranë, Prill 2017



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Embassy of Switzerland in Albania

## TABELA E PËRMBAJTJES

	Përmbledhje Ekzekutive	3
1	Hyrje	7
2	Shënim Metodologjik	7
3	Struktura e të Ardhurave Vendore	8
3.1	Burimet e Financimit të Bashkive në Vitin 2016	8
3.2	A Janë Rritur Financat Vendore në 2016?	10
3.3	Të Ardhurat e Veta nga Taksat dhe Tarifave Vendore	11
3.4	Diferencat e Bashkive në Performancën e Mbledhjes së Taksave dhe Tarifave Vendore	14
3.5	Sa Kanë Paguar Tatimpaguesit për Taksat dhe Tarifave Vendore?	16
3.6	Transferrat Ndërqeveritare të Kushtëzuara	17
4	Shpenzimet e Qeverisjes Vendore	19
4.1	Ku Shkojnë Paratë: Si i Shpenzuan Fondet Bashkitë në Vitin 2016?	19
4.2	Krahasimi me Vitet e Mëparshme: A Janë Rritur Shpenzimet Vendore?	20
4.3	Diferencat Ndërmjet Bashkive në Strukturën e Shpenzimeve	22
4.4	Ku Shkojnë Paratë: Ku Fokusohen Investimet Publike Vendore?	23
4.5	Ku Shkojnë Paratë: Në Cilat Funksione Shpenzohen Fondet e Përgjithshme?	25
5	Vërejtje Përfundimtare mbi Financat Vendore në Fund të Vitit të Parë të Reformës Administrative dhe Territoriale	26
	Aneksi 1	30
	Aneksi 2	35

© Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

*“Status Raporti mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore: Nga vijnë dhe si përdoren fondet publike nga bashkitë e reja?”* u realizua me mbështetjen e LëvizAlbania. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qendrimet e LëvizAlbania.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport ofron një pamje të përgjithshme të zhvillimit dhe gjendjes së financave vendore në fund të vitit 2016, duke bërë edhe krahasime me vitet e mëparshme e duke evidentuar diferencat apo pabarazitë ndërmjet 61 bashkive. Meqenëse ky është edhe viti i parë i plotë i zbatimit të Reformës Administrative dhe Territoriale (RAT) dhe transferimit në nivel vendor të një sërë funksionesh të reja, ky raport mund të shërbejë edhe për të informuar diskutimin mbi pritshmëritë nga reforma dhe hapat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin efektiv të këtyre reformave. Në raport evidentohen disa çështje të rëndësishme si më poshtë:

### **Nga pikëpamja e autonomisë fiskale dhe financiare, rezulton se në fund të vitit 2016:**

1. Autonomia fiskale vendore konsiderohet si një ndër elementët kryesorë për suksesin e reformave të decentralizimit. Autonomia fiskale mund të përkufizohet si - kontrolli mbi burime të mjaftueshme për të planifikuar dhe menaxhuar ofrimin e shërbimeve publike vendore sipas preferencave të qytetarëve, pa ndërhyrje të tepërta dhe të vazhdueshme nga nivelet më të larta të qeverisjes.
2. Parë në këtë këndvështrim, bashkitë në Shqipëri kanë të drejtë të kontrollojnë 63% të burimeve të financimit (75 nëse përfshijmë edhe fondet për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor), ndërkohë që qeveria qendrore kontrollon 37% (ose 25% nëse heqim fondet për funksionet e reja) të totalit të fondeve që shpenzohen në nivel vendor nëpërmjet transfertave të kushtëzuara.
3. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat përbëjnë mesatarisht 35% të totalit të burimeve të financimit, megjithëse një vështrim më i thelluar për 61 bashkitë individualisht tregon se ky raport varion nga 3% në 68%, duke evidentuar diferencat të theksuara kufizimet e kapacitetit fiskal, autonomisë financiare dhe varësisë nga qeverisja.
4. Në të njëjtën mënyrë, edhe pse Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit e cila mund të përdoret lirisht nga bashkitë mbetet burimi kryesor i financimit, duke përbërë mesatarisht mbi 50% të të ardhurave për 70% të bashkive të reja.
5. Rritja e madhësisë së transfertave të kushtëzuara përkundrejt burimeve mbi të cilat bashkitë ushtrojnë kontroll, tregon për një interes në rritje të qeverisjes qendrore për të influencuar apo drejtuar zhvillimet në nivel vendor.

### **Financat vendore në fund të vitit të parë të zbatimit të reformës administrative territoriale**

6. Rritja e të ardhurave nga administrimi më i mirë fiskal i taksave dhe tarifave vendore, reduktimi i kostove administrative të personelit, rritja e investimeve publike vendore deh zbutja e diferencave dhe pabarazive ndërmjet bashkive ishin ndër pritshmëritë kryesore të reformës administrative dhe territoriale.
7. Në nivel kombëtar, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në vitin 2016 janë rritur me rreth 3.7 miliard lekë ose 28%; Kontribuuesit kryesorë të rritjes së të ardhurave vendore janë taksa mbi pasurinë e paluajtshme (+19%), tarifat e shërbimeve të largimit të mbetjeve, ndriçimit publik dhe gjelbërimit (+58%), tarifat administrative (+27%) dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë (+94%).
8. Ndërkohë që ndryshimet në kuadrin ligjor për taksën e zënies së hapësirës publike, të tabelave dhe fjetjes në hotel kanë sjellë një rritje të të ardhurave vendore me rreth 500 milion lekë në vitin 2016, ndryshimet dhe zvogëlimi i kompetencave të bashkive mbi tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël i ka kushtuar bashkive rreth tre herë më shumë, duke humbur 1.5 miliard lekë në vitin 2016.
9. Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja, edhe pse në rritje të fortë në krahasim me vitin e kaluar vazhdojnë të ndikohen nga moratoriumi i lejeve për ndërtime të reja, ndryshimet në legjislationin për planifikimin e territorit dhe ecuria e aktivitetit ekonomik në përgjithësi.
10. Me tepër se burim të ardhurash, taksa e ndikimit në infrastrukturë do duhej të konsiderohej si detyrimi minimal i bashkive për investime për shërbimin me infrastrukturë publike të ndërtimit të ri. Në analizë evidentohet

se shpenzimet e bashkive për investime në infrastrukturë publike (transport, ujësjellës-kanalizime dhe arsim) janë më të ulta se të ardhurat e kësaj takse në vetëm 8 nga 61 bashkitë e reja, dhe në 6 nga këto 8 raste, të ardhurat nga taksa kanë qenë më pak se 10 milion lekë, duke treguar kështu edhe kapacitetin e ulët të këtyre bashkive për të kryer investime nga të ardhurat nga taksat e tarifato apo transferata e pakushtëzuar.

11. Transferimi i 6 funksioneve të reja në nivel vendor e vështirëson krahasimin e shpenzimeve administrative në raport me vitin 2015. Megjithatë, nëse heqim efektin e simuluar të funksioneve të reja, shpenzimet e për pagat e personelit dhe ato operative në fund të vitit 2016 rezultojnë me një rritje vjetore prej 2.4% (460 milion lekë) më të larta se ato të vitit 2015. Evidentohen diferenca të theksuara përsa i përket performancës individuale të bashkive: në 37 nga 61 bashkitë e reja, shpenzimet administrative të simuluar pa efektin e funksioneve të reja, kanë rënë mesatarisht me 14%, ndërkohë që në 24 bashki të tjera kostot administrative janë rritur mesatarisht me 9% në terma vjetorë.

12. Në të njëjtën kohë, investimet publike të financuara nga vetë bashkitë janë rritur me 26% ose 2.2 miliard lekë në krahasim me vitin 2015. Edhe në këtë rast, ekzistojnë diferenca të thella në performancën individuale të bashkive në drejtim të investimeve. Analiza e detajuar tregon se në 18 nga 61 bashkitë e reja, shpenzimet për investime kanë rënë nga -2 deri në -60% në terma vjetorë ndërkohë që në 18 bashki të tjera ato janë rritur me më shumë se 100% në krahasim me vitin 2015.

13. Në përfundim, në vitin e parë të plotë të zbatimit të reformës administrative dhe territoriale, evidentohet një rritje e të ardhurave nga taksat dhe tarifato vendore me 3.7 miliard lekë e cila pjesërisht është përkthyer në një rritje të investimeve publike me 2.2 miliard lekë. Përsa i përket shpenzimeve për pagat e personelit dhe atyre operative, nuk evidentohet një ulje e përgjithshme sikurse pritej nga reduktimi i numrit të njësive të vetëqeverisjes vendore nga 373 komuna dhe bashki në vetëm 61 bashki duke treguar se do të duhet kohë për shfaqjen e kursimeve dhe ekonomive të shkallës të pritura nga konsolidimi territorial. Megjithatë, duhet mbajtur në konsideratë se ekzistojnë diferenca të theksuara në performancën e bashkive në normën e rritjes së investimeve dhe uljes së kostove administrative.

### **Diferencat në performancën e mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore**

14. Ndonëse në nivel kombëtar të ardhurat nga taksat dhe tarifato vendore janë rritur me 28% në terma vjetorë, ekzistojnë diferenca të theksuara ndërmjet bashkive përsa i përket kapacitetit fiskal dhe mundësisë për të rritur të ardhurat nga taksat dhe tarifato: evidentohet se në 11 nga 61 bashkitë e reja të ardhurat në vitin 2016 kanë mbetur të pandryshuara ose kanë rënë me 2-32% krahasuar me vitin e mëparshëm; në 8 bashki të tjera rritja ka qenë midis 2% dhe 8%; në 24 bashki të ardhurat janë rritur me një normë midis 16% dhe 30%; në 18 bashki janë rritur me një normë midis 36% dhe 314%.

15. Nuk evidentohet një lidhje e fortë midis performancës së bashkive në rritjen e të ardhurave të veta me madhësinë e tyre. Grupi i bashkive me rritjen më të madhe të të ardhurave ka një popullsi mesatare prej 21,500 banorësh ndërkohë që grupi i 11 bashkive me të ardhura të barabarta apo më të ulta se viti 2015, ka në përbërje 4 prej 10 bashkive më të mëdha të vendit. Kjo evidencë duket sikur e dobëson pritshmërinë e reformës administrative territoriale për rritje automatike të të ardhurave sidomos nga bashkitë e mëdha të cilat kishin edhe kapacitetet për të menaxhuar më mirë politikën fiskale edhe në territoret e shtuara nga ish-komunat. Kjo tregon se, pavarësisht madhësisë, të gjitha bashkitë do të duhet të investojnë burime të konsiderueshme dhe kohë për të rritur kapacitetet për administrimin fiskal dhe financiar në një territor më të madh.

16. Në vlerësimin e arsyeve që kanë çuar në rritjen e të ardhurave të veta vendore, dhe në diferencat në performancën e bashkive një rol i rëndësishëm mund t'i atribuohet reduktimit të vazhdueshëm të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe pasigurisë në rritje të të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të cilat kanë shtyrë mjaft bashki të administrojnë më mirë taksat dhe tarifato e tjera vendore, duke zgjeruar bazën e taksueshme, duke nisur apo intensifikuar bashkëpunimet me agjentë tatimorë, nëpërmjet forcimit të masave për mbledhjen në kohë të detyrimeve fiskale, ndjekjen e detyrimeve të vonuara etj.

17. Një arsye tjetër që mund të ketë pasur një rol të rëndësishëm është edhe rritja e nivelit të taksave dhe sidomos tarifave vendore, të cilat ndryshe nga të parat që përcaktohen me ligj, janë në vendimmarrjen e plotë të bashkive.

18. Rëndësia që i është kushtuar këtyre dimensioneve nga bashki të ndryshme patjetër që kanë ndikuar në performancën finale të mbledhjes së të ardhurave.

### **Sistemi i transfertave ndërqeveritare të kushtëzuara dhe pritshmëritë për një zhvillim më të balancuar ekonomik dhe territorial**

19. Transfertat e kushtëzuara nga qeverisja qendrore në vitin 2016 ishin rreth 12 miliardë lekë, ose 11% më shumë se në vitin 2015 dhe rreth 50% më shumë se në vitin 2011.

20. Ato fokusohen kryesisht në infrastrukturë publike, transport, arsim dhe ujësjellës-kanalizime, përkundër faktit se sipas legjislacionit këto janë funksione ekskluzive vendore, dhe si të tilla do duhej të financoheshin me fonde të cilat bashkitë mund ti përdorin lirisht.

21. Nivelet e larta të këtyre transfertave në raport me ato të pakushtëzuara tregojnë se qeverisja qendrore vazhdon më mbajë një nivel të lartë kontrolli të aktiviteteve dhe zhvillimeve në nivel vendor përkundër reformave decentralizuese të ndërmarra. Të dhënat tregojnë se në 37 nga 61 bashkitë, investimet e financuara nga qeveria qendrore janë nga 1 deri në 17 herë më të larta se investimet e financuara nga vetë bashkitë duke treguar kështu mundësitë e pakta të bashkive për të financuar investimet nëpërmjet burimeve mbi të cilat ata ushtrojnë kontroll.

22. Vërehen diferenca të forta në trajtimin e bashkive me transferta të kushtëzuara. Fondet e transferuara variojnë nga 0-40.000 lekë për banorë, të cilat kontribuojnë në thellimin e diferencave ndërmjet bashkive dhe në ashpërsimin e debatit mbi mënyrën se si alokohen këto transferta.

### **Ku shkojnë paratë: si i shpenzuan fondet publike bashkitë në vitin 2016?**

23. Në fund të vitit 2016, shpenzimet totale vendore ishin 48.7 miliard lekë, nga të cilat 75% e janë financuar nga burimet e veta të bashkive, ndërsa 25% janë financuar me transferta të kushtëzuara nga qeverisja qendrore.

24. Nga shpenzimet e financuara nga vetë bashkitë, 43% kanë shkuar për pagat e personelit; 27% për shpenzimet operative të funksionimit të bashkisë; 28% për investime publike dhe 2% për subvencione dhe transferta të brendshme.

25. Ekzistojnë diferenca të forta ndërmjet bashkive përsa i përket strukturës së shpenzimeve: pagat për personelin përbëjnë 30-70% të shpenzimeve të veta; shpenzimet operative përbëjnë 13-46%; ndërkohë që investimet përbëjnë 5-55% të buxheteve të bashkive.

26. Parë nga ana e funksioneve, në 2016, bashkitë kanë dedikuar mesatarisht 26% të buxheteve të tyre për administratën, 21% për infrastrukturën publike, 21% për shërbimet publike të pastrimit dhe largimit të mbetjeve, ndriçimit publik, gjelbërimit etj.; 20% për kopshtet, çerdhet dhe arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm; 8% për sportin, kulturën dhe qendrat sociale për njerëzit në nevojë; dhe së fundmi vetëm 1% për furnizimin me ujë;

Ku shkojnë paratë: ku fokusohen investimet publike vendore?

27. Në vitin 2016, 59% e investimeve të vetë bashkive u fokusuan në infrastrukturë publike e sidomos atë të transportit, 22% në përmirësimin e shërbimeve publike vendore; 10% në funksionet e administratës qendrore; 7% për sistemin e arsimit parauniversitar; ndërkohë që vetëm 2% janë dedikuar për funksionet e kulturës, mbrojtjes sociale dhe shëndetësisë.

### **Sa kushton qeverisja vendore dhe sa paguajmë për taksat dhe tarifat vendore?**

28. Qeverisja vendore u kushton tatimpaguesve rreth 36.6 miliard lekë, ose 269.3 milion euro në vit, nga të cilat 25.6 miliard lekë ose 188.3 milion euro shkojnë për pagat e personelit të bashkive dhe shpenzime të tjera operative,

10.1 miliard lekë ose 74.7 milion euro për investime dhe 860 milion lekë ose 6.2 milion euro për subvencione dhe transferta.

29. Në terma të shpenzimeve për banor, qeverisja vendore kushton rreth 12.600 lekë (ose 93 Euro) në vit; nga të cilat, 8840 lekë (65 Euro) për pagat dhe shpenzimet operative, 3500 lekë (ose 25.8 euro) për investime dhe 292 lekë (2 euro) për subvencione dhe transferta të brendshme. Nëse eliminojmë efektin e funksioneve të reja, shpenzimet për pagat e personelit dhe operativet bien nga 8840 lekë në 6874 lekë (ose 50.6) euro për banorë.

30. Nga ana tjetër, në vitin 2016, tatimpaguesit u kanë paguar bashkive gjithsej rreth 16.8 miliard lekë ose 123.4 milion Euro në formën e taksave dhe tarifa vendore. Nga të dhënat për të ardhurat për frymë, rezulton se çdo qytetar shqiptar do të paguante rreth 5,800 lekë (ose 42.6 Euro) në vit në formën e taksave dhe tarifave për bashkinë.

31. Mesatarisht dhe pa marrë në konsideratë diferencat ligjore në trajtimin e taksave në qytete të ndryshme, rezulton se për një familje me katër pjesëtarë, detyrimi tatimor do të ishte rreth 23 mijë lekë ose 170 euro në vit, pra pothuajse sa një pagë mujore minimale. Qartësisht familjet shqiptare nuk paguajnë nivele të tilla për taksat dhe tarifatat vendore, duke treguar që pjesa më e madhe e barrës fiskale të bjerë mbi tatimpaguesit biznese.

## 1 HYRJE

Transparenca mbi përdorimin e fondeve publike është shumë e rëndësishme për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e qytetarëve në vendimmarrje dhe rritjen e përgjegjshmërisë së të zgjedhurve ndaj qytetarëve. Megjithatë, bashkitë jo gjithmonë publikojnë apo vënë në dispozicion të qytetarëve, në kohën dhe mënyrën e duhur, informacion për menaxhimin financiar të bashkisë.

Qëllimi i këtij raporti monitorimi të financave vendore në fund të vitit 2016, është të hedhë dritë mbi dhe të ofrojë një analizë të burimeve të financimit të 61 bashkive të reja, të kostos së shërbimeve që ofrohen nga bashkitë dhe të mënyrës së përdorimit të burimeve financiare publike në nivel vendor.

Ky raport paraqet një analizë të performancës, tendencave dhe situatës financiare të 61 bashkive të reja në fund të vitit 2016. Meqenëse viti 2016 është edhe viti i parë i plotë i zbatimit të Reformës Administrative dhe Territoriale (RAT) dhe decentralizimit të funksioneve të reja, ky raport mund të shërbejë edhe për të informuar diskutimin mbi pritshmëritë nga reforma dhe hapat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin efektiv të saj. Raporti gjithashtu mund të vijë në ndihmë vetë bashkive nëpërmjet analizave krahasimore me vitet e mëparshme, pra para konsolidimit territorial, me mesataren kombëtare apo bashkitë e tjera.

Për të ndihmuar në analizë, raporti ofron krahasime të të ardhurave dhe shpenzimeve në terma vjetorë me vitet mëparshme, dhe prezanton disa konkluzione mbi tendencat e financave vendore. Nga pikëpamja metodologjike, krahasimi me të dhënat faktike të viteve të mëparshme bëhet duke iu referuar 373 njësisve të qeverisjes vendore të cilat janë konsoliduar në nivelin e 61 bashkive. Kjo mundëson nxjerrjen e disa konkluzioneve paraprake mbi përmirësimet e sjella nga reforma administrative territoriale në eficiencën operacionale të bashkive të reja të sapokrijuara.

Ky raport, pason raportin e hartuar nga Co-Plan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, për gjendjen e financave vendore në fund të vitit 2015, si viti hibrid i përfundimit të ndarjes së vjetër administrative dhe hyrjes në fuqi të ndarjes së re. Raporti i vitit 2016 shërben kështu edhe si baza kryesore për të matur performancën dhe progresin e bashkive. Të dy këto raporte vjetore, së bashku me një seri raportesh tremujore mbi gjendjen e financave vendore në tremujorin e parë, të dytë dhe të tretë të vitit 2016 janë publikuar në platformën [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al).

## 2 SHËNIM METODOLOGJIK

Në zhvillimin e këtij raporti vjetor për financat e qeverisjes vendore, janë përdorur të dhënat e siguruar përmes portalit të Financave Vendore [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), bazuar në të dhënat e Sistemit Informatik Financiar Qeverisë (sistemi i Thesarit) për periudhën 2011-2016. Gjithashtu jemi mbështetur edhe në studime dhe analiza të kryera nga Projekti i USAID-it, Për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP), në veçanti në Raportin Statistikor mbi Financat e Qeverisjes Vendore në Shqipëri, 2002-2015, si dhe raportet dhe dokumentet analitike të Ministrisë së Financave mbi qeverisjen dhe financat vendore.

Raporti bazohet në të dhënat vjetore për të ardhurat dhe shpenzimet faktike dhe transfertat ndërqeveritare për nivelin e parë të qeverisjes vendore, pra për bashkitë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, (Ligji Organik i Buxhetit – LOB), duke ndjekur klasifikimin administrativ, ekonomik, funksional dhe sipas burimeve të financimit. Raport përfshin të dhënat për 61 bashkitë dhe gjithë njësitë shpenzuese në varësinë e tyre, kategorizimin e transaksioneve të bazuara në: natyrën ekonomike (paga, operative, investime); funksionet e qeverisë (p.sh. arsimit, infrastruktura, shërbimet publike, shërbimet e furnizimit me ujë

1. Shih Ligjin 139/2015, Për Vetëqeverisjen Vendore. Funksionet e reja të transferuara në nivel vendor janë personeli edukativ në sistemin e arsimit parashkollor, personeli i mirëmbajtjes në sistemin e arsimit parauniversitar, mbrojtja nga zjarri, administrimi i pyjeve, ujitja dhe kullimi etj.

dhe kanalizimeve etj.); dhe të ndara sipas burimit të financimit (p.sh. të ardhura të krijuara nga burimet e veta vendore apo transferta ndërqeveritare, dhe shpenzime të financuara me burimet e veta dhe nga transferta të kushtëzuara nga qeveria qendrore).

Transfertat e kushtëzuara përfshijnë të financimet nga ministrinë dhe Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) për përgjegjësitë dhe funksionet e përbashkëta ose të deleguara. Megjithatë termi funksione të përbashkëta, është shfuqizuar me Ligjin e ri për Vetëqeverisjen Vendore, në fakt ka një sërë funksionesh për të cilat dy nivelet e qeverisjes vazhdojnë të ndajnë përgjegjësi, si arsimi, transporti, zhvillimi ekonomik, zhvillimi urban etj. Transfertat nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për ndihmën ekonomike, të cilat transferohen në nivel vendor, për t'u shpërndarë nga bashkitë pranë grupeve vulnerabël, nuk janë përfshirë në analizë. Në sistemin e thesarit, transfertat specifike regjistrohen në të njëjtën llogari ekonomike që përdoret për transfertën e pakushtëzuar, duke e bërë të pamundur ndarjen e fondeve "faktike" të transfertës së pakushtëzuar dhe asaj specifike. Një mënyrë për të bërë një ndarje të këtyre dy lloj transfertash është të përdoren të dhënat për transfertat specifike të përcaktuara për çdo bashki në Ligjin e Buxhetit Vjetor 2016, me supozimin që fondet e transfertave specifike të planifikuara atje janë transferuar 100% në nivel vendor.

Së fundmi, për periudhën 2011-2015, raporti konsolidon të dhënat financiare të 373 Bashkive dhe Komunave-ve në vetëm 61 Bashki sipas reformës administrative dhe territoriale, duke lejuar kështu më shumë krahasueshmëri për vitet në vijim. Për prodhimin e të dhënave për frymë janë përdorur të dhënat e popullsisë sipas Censurit të vitit 2011.


### 3 STRUKTURA E TË ARDHURAVE VENDORE

Ky seksion paraqet një analizë të strukturës së të ardhurave dhe burimeve të financimit të 61 bashkive të reja në fund të vitit 2016 duke bërë edhe krahasimet me vitet e mëparshme për parë performancën në fund të vitit të parë të zbatimit të reformës administrative dhe territoriale. E thënë ndryshe, ky seksion tregon nga vijnë fondet me të cilat bashkitë ushtrojnë funksionet dhe përgjegjësitë dhe nëse ato janë rritur në krahasim me vitet e mëparshme duke krijuar kështu parakushtet për të ofruar më shumë apo shërbime më të mira për qytetarët.

#### 3.1 Burimet e Financimit të Bashkive në Vitin 2016

Grafiku 1 paraqet strukturën e burimeve të financimit në vitin 2016. Sikurse mund të vihet re, të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifave vendore së bashku përbëjnë 34.8% e totalit të burimeve financiare; transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit zë 26.1% të totalit dhe mund të përdoret pothuajse lirisht nga bashkitë ; taksat e ndara, të cilat përfshijnë të ardhurat nga taksat vjetore e automjeteve të përdorura dhe rentën minerare, përbëjnë 2.2% të totalit; transfertat specifike për funksionet e reja të decentralizuara me ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" përbëjnë 11.9% të totalit; transfertat e kushtëzuara nga ministrinë e linjës për funksionet e deleguara dhe financimet nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, përbëjnë 24.5% të totalit të financimit. ministrinë e linjës për funksionet e deleguara dhe financimet nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, përbëjnë 24.5% të totalit të financimit.

**Grafiku 1:** Struktura e burimeve të financimit vendor në fund të 2016, në % ndaj totalit.




**Burimi:** [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

2. Qeveria qendrore, shpesh ka përcaktuar rregulla për mënyrën e përdorimit të transfertës së pakushtëzuar, herë duke përcaktuar kufij mbi shpenzimet e personelit apo për investime. Në vitin 2016, ishte përcaktuar që, minimalisht, bashkitë duhej të përdornin 40% të transfertës për investime publike.



**Grafiku A1:** Peshat specifike e burimeve të financimit të bashkive në vitin 2016, në përqindje ndaj totalit.



Një nga elementët kryesorë që ndikon në suksesin e reformave decentralizuese është autonomia fiskale vendore - kontrolli mbi burime të mjaftueshme për të planifikuar dhe menaxhuar ofrimin e shërbimeve publike vendore sipas preferencave të qytetarëve, pa ndërhyrje të tepërta dhe të vazhdueshme nga nivelet më të larta të qeverisjes. Parë në këtë këndvështrim, **bashkitë në Shqipëri ushtrojnë kontroll të plotë apo pothuajse të plotë mbi 63% të burimeve të financimit<sup>3</sup>, ndërkohë që rreth 37% e tyre kontrollohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qeveria qendrore.**

**Peshat specifike e burimeve të financimit në buxhetet vendore është një tregues i drejtpërdrejtë i autonomisë financiare dhe potencialisht i kapacitetit fiskal.**

Grafiku A1, tregon diferencat e forta ndërmjet bashkive përsa i përket pesës specifike të burimeve të financimit ndaj totalit. Nëse të ardhurat nga taksat dhe tarifatat në vitin 2016, përbëjnë 68% të të ardhurave totale të bashkisë Tiranë, në bashkinë e Hasit ato zënë vetëm 3% të totalit, duke treguar kështu diferencat të forta në kapacitetin fiskal dhe autonominë financiare. **Në disa raste peshat e tarifave të shërbimeve publike është shumë afër apo edhe më e lartë se peshat e taksave në raport me totalin, duke treguar kështu se barra fiskale për tarifatat, për të njëjtët tatimpagues është më e lartë se ajo e taksave.** Ndërkohë kjo mund të reflektojë edhe faktin që në këto bashki, mbledhjes së tarifave u kushtohet më shumë vëmendje se mbledhjes së taksave.

Në vitin 2016, në mjaft bashki, transfertat e kushtëzuara zënë një peshë të njëjtë apo më të madhe sesa transfertat e pakushtëzuara, duke treguar kështu edhe varësinë e bashkive nga transfertat nga qeveria qendrore dhe mundësitë e kufizuara për financimin e investimeve strategjike. **Transferta e pakushtëzuara mbetet burimi kryesor i financimit, duke përbërë mesatarisht mbi 50% të të ardhurave për rreth 70% të bashkive të reja. Në përfundim, nëse në nivel kombëtar, bashkitë kontrollojnë rreth 63% të buxhetit të tyre, në nivel individual ka diferencat të theksuara, ku shkalla e kontrollit varion nga 36% deri në 97% të buxhetit. Diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket strukturës së financave paraqiten në mënyrë më të plotë në Aneksin nr. 1 bashkëlidhur këtij raport.**

3. Nëse konsiderojmë edhe transfertat specifike për funksionet e reja, ky raport është 75%. Në analizën e shpenzimeve, fondet për këto funksione janë konsideruar si shpenzime të vetë bashkive, sepse edhe në sistemin e thesarit këto fonde raportohen si të tilla.


### 3.2 A janë rritur Financat Vendore në vitin 2016?

Rritja e të ardhurave vendore si pasojë e një menaxhimi më të mirë fiskal nga konsolidimi territorial ishte një nga synimet kryesore të Reformës Administrative Territoriale. Në të njëjtën kohë, përmirësimi i shërbimeve publike sikurse premtuar nga kjo reformë kërkon një rritje të fondeve të disponueshme të bashkive.

Para se të analizohen financat vendore për vitin 2016, paraprakisht duhet specifikuar se viti 2016 është edhe viti i decentralizimit të një sërë funksionesh të reja, të cilat janë financuar me transferta specifike, në nivelin 5.7 miliard lekë. Një analizë e thelluar e mjaftueshmërisë së fondeve të financimit për funksionet e reja shkon përtej objektivit të këtij raporti, megjithatë, duhet thënë se mjaft bashki kanë ngritur këtë shqetësim, dhe në fakt, fondi prej 5.7 miliard lekë i alokuar me Ligjin e Buxhetit për Vitin 2017 mbulon vetëm shpenzimet e personelit dhe pak shpenzime operative për funksionet e reja ndërkohë që nuk janë dhënë fonde për investime<sup>4</sup>.

Grafiku nr. 2, vjen në ndihmë për të parë se si kanë evoluar burimet e financimit të qeverisjes vendore në kohë, para dhe pas reformës administrative territoriale, dhe për të parë nëse ka përmirësime në administrimin fiskal vendore apo nëse qeverisja qendrore ka shtuar burimet e financimit për qeverisjen vendore.

**Grafiku 2:** Financat Vendore, 2011-2016, në miliard lekë.



**Burimi:** [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

Sikurse u përmend më sipër, transferimi i funksioneve të reja u shoqërua me transferta specifike, në shumën prej 5.7 miliard lekë. Nëse eliminojmë efektin e transfertave specifike, të cilat nuk mund të konsiderohen si rritje të ardhurash pasi shkojnë për funksionet dhe përgjegjësitë e reja të bashkive, **financat publike vendore në vitin 2016 janë 47.7 miliard lekë dhe janë rritur me rreth 5.7 miliard lekë (ose 16%), nga të cilat 4.6 miliardë lekë janë fonde mbi të cilat bashkitë mund të ushtrojnë kontroll të plotë dhe rreth 1 miliard lekë janë transferta të kushtëzuara.**

4. Me ligjin e buxhetit të vitit 2016, financimet për funksionet e reja dhe transfertat specifike të alokuara për secilën bashki janë rreth 5.9 miliard lekë. Në të njëjtën mënyrë, në zbatim të Aktit Normativ nr. 2, datë 16.12.2016 dhe Vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 925 dhe 926, datë 21.12.2016, në ditët e fundit të vitit 2016, janë transferuar në nivel vendor rreth 2 miliard lekë për investime në infrastrukturën rrugore, me përfitues 30 bashki, dhe rreth 1 miliard lekë të tjera për funksionin e ujitjes dhe kullimit, me përfitues 43 bashki. Këto fonde janë trashëguar për vitin 2017. Grafiku tregon fondet e lëvruara dhe faktikisht të përdorura për funksionet e reja për vitin 2017.



**Të ardhurat nga tarifat vendore kanë njohur rritjen më të madhe, me 45% në terma vjetorë, ndjekur nga të ardhurat nga taksat vendore me 19% dhe transfertat e pakushtëzuar me 11% në terma vjetorë. Të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara nga ministritë e linjës dhe Fondi për Zhvillimin e Rajoneve janë rritur me 8% në krahasim me vitin e mëparshëm ndërkohë që të ardhurat nga taksat e ndara (taksa vjetore e mjeteve të përdorura dhe renta minerare) kanë rënë me rreth 8% në terma vjetore.** Në seksionin në vijim jepet një analizë e plotë e performancës së bashkive në administrimin e taksave dhe tarifave vendore dhe një analizë e transfertave ndërqeveritare dhe efekteve për secilën bashki.

### 3.3 Të Ardhurat e Veta nga Taksat dhe Tarifat Vendore


Nëse konsiderojmë vetëm taksat dhe tarifat vendore, burimi mbi të cilin bashkitë kanë autoritet të plotë, të ardhurat në vitin 2016 janë rritur me 3.7 miliard lekë ose 28% në krahasim me vitin 2015. Para se të analizojmë nga vjen kjo rritje më poshtë paraqiten zërat kryesorë të taksave dhe tarifave vendore që paguajnë taksapaguesit. Grafiku 3 tregon strukturën e të ardhurave të veta në vitin 2016, në përqindje ndaj totalit dhe në miliard lekë.

**Grafiku 3:** Struktura e të ardhurave të veta në vitin 2016.

në përqindje ndaj totalit



në miliard lekë




**Burimi:** [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

Sikurse mund të vihet re, taksa e pasurisë së paluajtshme mbi ndërtesat, tarifat e shërbimeve publike të ofruara nga bashkia (pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi publik), tarifat për shërbimet administrative, dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja zënë peshën kryesore të të ardhurave të veta të bashkive. Të marra së bashku këto përbëjnë 12.8 miliard lekë ose 76% të të ardhurave të veta të bashkive prej 16.8 miliard lekësh. Ndërkohë të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin përbëjnë vetëm 4% të të ardhurave të veta vendore; Tarifa e hapësirës publike gjithashtu përbën 4% të të ardhurave vendore; taksa e kalimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme dhe taksa e tabelës gjenerojnë 3% të të ardhurave të veta vendore respektivisht, ndërkohë që taksa e fjetjes në hotel gjeneron vetëm 1% të të ardhurave. Burimet e tjera të financimit zënë rreth 9% të të ardhurave dhe në to përfshihen taksa dhe tarifa të tjera vendore, donacionet, të ardhurat nga dhënia me qera e aseteve vendore etj.

**Por cilat janë taksat dhe tarifat vendore që kanë sjellë rritjen e të ardhurave dhe cila është performanca individuale e bashkive në raport me rritjen mesatare prej 28.5%? Të tre këto çështje analizohen në vijim.**

Për të kuptuar më mirë strukturën e të ardhurave të veta dhe performancën e bashkive në vite, para dhe pas reformës administrative dhe territoriale, mund ti referohemi grafikut 4. **Kontribuuesit kryesorë të rritjes së të ardhurave vendore janë taksa mbi pasurinë e paluajtshme (+19% ose 640 milion lekë), tarifat e shërbimeve të largimit të mbetjeve, ndriçimit publik dhe gjelbërimit (+58% ose 1.2 miliard lekë), tarifat administrative (+27% ose 580 milion lekë) dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë (+94% ose 1.4 miliard lekë).** Ndryshimi i legjislacionit dhe zvogëlimi i kompetencave të bashkive mbi tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël (TTFBV) ka sjellë efekte negative për bashkitë, të cilat në krahasim me vitin 2015, kanë humbur rreth 1.5 miliardë lekë nga kjo taksë, duke marrë vetëm 600 milion nga 2.1 miliardë që ishte në vitin 2015, ose 70% më pak se viti i mëparshëm<sup>5</sup>.

**Grafiku 4:** Krahasimi i përbërjes së të ardhurave të veta, 2011-2016, në miliard lekë.



**Burimi:** [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

Ndryshimet ligjore që sollën kthimin e taksave të zënies së hapësirës publike dhe tabelave në tarifa vendore duket të kenë sjellë efekte pozitive. Të ardhurat nga këto dy burime janë rritur nga 700 milion lekë në vitin 2015 në rreth 1.2 miliardë lekë në vitin 2016, duke regjistruar kështu një rritje vjetore prej rreth 500 milion lekë apo 71%. Ndryshimi i politikës fiskale mbi taksën e akomodimit në hotele duket se ka rritur të ardhurat me rreth 50%, megjithëse niveli absolut i të ardhurave nga taksa vazhdon të mbetet shumë i ulët, në nivelin 150 milion lekë në fund të vitit 2016.


Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja, edhe pse në rritje në krahasim me vitin e kaluar vazhdojnë të ndikohen nga moratoriumi i lejeve për ndërtime të reja, ndryshimet në legjislacionin për planifikimin e territorit dhe ecuria e aktivitetit ekonomik në përgjithësi. Ndërkohë që kjo taksë vazhdon të mbetet ndër kontribuuesit më të rëndësishëm të buxhetit për mjaft bashki, duhet mbajtur në konsideratë se më shumë se sa një burim financimi, të ardhurat e kësaj takse do duhej të konsideroheshin si detyrim i bashkisë për të ndërtuar infrastrukturën publike të nevojshme për shërbimin e këtyre ndërtimeve të reja. E thënë ndryshe, të ardhurat e kësaj takse do duhej të përdreshin ekskluzivisht për financimin e investimeve publike në vendin ku kryhet ndërtimi i ri dhe të mos përdorej për shpenzimet e pagat e personelit bashkiak apo shpenzime të tjera operative të bashkisë. Për sa më sipër, nëse taksën e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja e heqim nga analiza, me arsyetimin se të ardhurat nga do duhej të përdreshin ekskluzivisht për investime publike, dhe meqenëse vetë këto të ardhura varen më tepër nga kërkesa për zhvillim dhe punët publike të financuara nga qeverisja qendrore, **të ardhurat e veta**

5. Prej janarit 2016, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël ka pësuar një ndryshim rrënjësor ku të gjitha bizneset e vogla me xhiro vjetore nën 5 milion lekë janë përjashtuar nga detyrimi tatimor, ndërkohë që për bizneset e vogla me xhiro vjetore nga 5-8 milion lekë shkalla tatimore u përgjysmua.

### vendore në vitin 2016 rezulton të jenë rritur me 20% në krahasim me vitin 2015.

Grafiku 5 paraqet përbërjen e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme (ndërtesa dhe toka bujqësore) dhe taksën mbi transferimin e pasurisë së paluajtshme në periudhën 2011-2016.

Grafiku 5: Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (2011-2016, në milion lekë).



Burimi: [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

**Të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat, të cilat zënë peshën më të rëndësishme janë rritur me 16 % ose rreth 450 milion lekë, në krahasim me vitin e mëparshëm. Taksa mbi tokën bujqësore vazhdon të zërë një peshë modeste dhe të ardhurat prej saj janë rritur me vetëm 184 milion lekë në krahasim me vitin 2015.** Të ardhurat e kësaj gjithashtu mund të përdoren për të analizuar performancën e bashkive të reja në administrimin e një tatimi që ka qenë kompetencë ekskluzive e ish-Komunave. Duket sikur **do duhet më shumë kohë për të parë përmirësime të ndjeshme të të ardhurave vendore nga bashkitë e reja në territorin e ish-komunave.**

Të ardhurat nga taksa e transferimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme administrohet nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe më pas ndahet me bashkitë. Të ardhurat prej kësaj takse reflektojnë shit-blerjet e pasurive të paluajtshme nga personat juridikë. Duket se në vitin 2016, të ardhurat na kjo taksë kanë rënë me 3.7% në krahasim me vitin e mëparshëm. Gjithashtu, vlen të theksohet se në raportet e sistemit të Thesarit nuk evidentohen të ardhura nga taksa mbi truallin urban e prezantuar së fundmi. Mungesa e informacionit mbi të ardhurat e kësaj takse mund të lidhet me probleme të raportimit financiar. Megjithatë nuk duhet neglizhuar edhe problemi i mungesës pothuajse totale të regjistrave të bazës së taksës (dhe taksapaguesve) për këtë taksë. Në këtë drejtim, një vlerësim më i thellë sugjerohet të kryhet nga autoritetet fiskale.

### Cilat janë arsyet që kanë çuar në rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore?


Së pari, vlerësohet se reduktimi i të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe pasiguria në rritje e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, ka rezultuar në një shtysë të rëndësishme për bashkitë që të përmirësojnë administrimin e taksave dhe tarifave të tjera vendore. Në të njëjtën kohë, mjaft bashki kanë shtuar

punën për të administruar më mirë taksat dhe tarifave nga taksapaguesit familjarë duke filluar apo intensifikuar bashkëpunimet me agjentë tatimorë, si p.sh., ndërmarrjet e Ujësjellës Kanalizimeve për mbledhjen e detyrimeve vendore. Krahas intensifikimit të punës së administratës bashkiake në kahun e mbledhjes së të ardhurave, për disa bashki të tjera, element tjetër që mund të ketë kontribuar në rritjen e të ardhurave është rritja e nivelit të taksave dhe tarifave. Një analizë më e thelluar e niveleve të taksave dhe tarifave vendore mund të kryhet duke konsultuar Vendimet e Këshillave Bashkiake për nivelet e taksave dhe tarifave në juridiksionin e tyre. Një kopje e këtyre vendimeve mund të shkarkohet në platformën [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al).

### 3.4 Diferencat e Bashkive në Performancën e Mbledhjes së Taksave dhe Tarifave Vendore

Ndonëse të ardhurat e veta të qeverisjes vendore nga taksat dhe tarifave vendore në vitin 2016 janë rritur me 28% në terma vjetorë, është e rëndësishme të analizojmë se si krahasohen bashkitë individuale në raport me këtë shifër. Grafiku 6 tregon pikërisht ekzistencën e diferencave të thella në performancën individuale të 61 bashkive të reja në mbledhjen e të ardhurave të veta për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015. Një paraqitje më e plotë e diferencave

**Grafiku 6:** Norma e rritjes së të ardhurave të veta në vitin 2016 për 61 bashkitë e reja.




të bashkive në performancën e rritjes së të ardhurave jepet në Aneksin nr. 1 të këtij raporti.

**Konkretisht, në 11 nga 61 bashkitë e reja të ardhurat në vitin 2016 janë ulur ose kanë mbetur të pandryshuara krahasuar me vitin e mëparshëm; në 8 bashki të tjera rritja ka qenë midis 2% dhe 8%; në 24 bashki të ardhurat janë rritur me një normë midis 16% dhe 30%; në 9 bashki janë rritur me një normë midis 36% dhe 57%; ndërkohë që në 9 bashki të tjera janë rritur me një normë midis 65% dhe 314%.**

**Si shpjegohen diferencat e theksuara në performancën e bashkive në rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore?**

**Arsyet pas diferencave të theksuara në normën e rritjes vjetore të të ardhurave të veta vlen të analizohen specifikisht rast pas rasti, pasi shpesh diktohen nga kushte të veçanta apo edhe të përkohshme.** Ndër elementët që vlerësohet mund të ketë ndikuar ecurinë e ritmit vjetor të rritjes është taksat e ndikimit në infrastrukturë. Të ardhurat kjo taksë duke qenë drejtpërsëdrejti të lidhura me kërkesën për ndërtime të reja, shfaq një luhatshmëri shumë të madhe nga viti në vit. Nëse do të eliminonim taksën e ndikimit në infrastrukturë nga llogaritja e të ardhurave të veta të bashkive, do të shikonim një pamje shumë më të ndryshme të performancës së bashkive. Grafiku 7 tregon se, duke **përfshirë taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, norma vjetore mesatare e rritjes së të ardhurave është më e moderuar dhe paraqet luhatshmëri më të ulët.** Ka edhe raste të tjera ku norma e rritjes rezultojn më




**Grafiku 7:** Norma e rritjes së të ardhurave të veta pa taksën e ndikimit në infrastrukturë, viti 2016.

**Burimi:** [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

e lartë, pasi taksa e ndikimit në infrastrukturë ka pasur një ndikim negativ në vitet e mëparshme dhe eliminimi i saj nga përllogaritja në të dy vitet çon në një normë rritjeje më të lartë.

Të dhënat e grafikut 6 dhe 7 tregojnë që **pavarësisht nëse konsiderojmë apo jo taksën e ndikimit në infrastrukturë, performanca e bashkive në rritjen e të ardhurave të veta nuk lidhet shumë me madhësinë e saj.** Sipas të dhënave, grupi i bashkive me rritjen më të madhe të të ardhurave ka një popullsi mesatare prej 21,500 banorësh (sipas Censurit të vitit 2011); Ndërkohë, grupi i bashkive me rritje pozitive por më të ulët se 10%, ka një popullsi mesatare prej 61,000 banorësh. Së fundmi, grupi i 11 bashkive me të ardhura të barabarta apo më të ulta krahasuar me vitin 2015, ka në përbërje 4 prej 10 bashkive më të mëdha të vendit në terma numrit të popullsisë dhe të ardhurave për frymë.

Grafiku 8 më poshtë e përforcon argumentin e lidhjes së dobët midis madhësisë së bashkisë dhe rritjes së të ardhurave

**Grafiku 8:** Lidhja e treguesit të të ardhurave me treguesin e madhësisë e bashkisë.

**Burimi:** [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

për frymë. Për të rritur qartësinë e grafikut, janë hequr dy bashkitë më mëdha dhe dy bashkitë me të vogla në terma të popullsisë. Në krahun e majtë grafiku 8 tregon marrëdhënien ndërmjet të ardhurave për banor në vitin 2016 dhe madhësisë së bashkisë sipas popullsisë (me bazë Census 2011), ndërkohë që në krahun e djathtë tregohet lidhja midis normës së rritjes së të ardhurave vendore dhe madhësisë së bashkisë.

Sikurse mund të evidentohet, shumica e 61 bashkive të reja kanë të ardhura për frymë nën 5,000 lekë për banor (mesatarja kombëtare është 4,600 dhe 5,600 lekë për banor në vitin 2015 dhe 2016, respektivisht). Në të njëjtën kohë të gjitha bashkitë me popullsi më të madhe se 40,000 banorë sipas Censurit, kanë të ardhura për frymë nën 5,000 lekë për banor. **Pra, duket se nuk ekziston një lidhje e fortë midis madhësisë së bashkisë dhe të ardhurave për frymë.** E thënë ndryshe, të ardhurat për banorë janë relativisht më të ulta në bashkitë e mëdha. Përtej numrit më të lartë të banorëve, **kjo mund të tregojë edhe më shumë vështirësi në menaxhimin e një territori dhe numri taksapaguesish më të madh nga administrata fiskale bashkiake.** Ashtu si dhe pritej, **bashkitë e vogla përgjithësisht shfaqin norma rritjeje më të larta se bashkitë e mëdha** (grafiku 8, djathtas). Një element tjetër që mund të evidentohet nga paraqitja grafike është konfirmimi i faktit se bashkitë e vogla dhe të mesme shfaqin një varësi më të lartë nga të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë se bashkitë e mëdha. Në këto të fundit, norma e rritjes së të ardhurave, përgjithësisht mbetet e pandryshuar, ose ndryshon pak kur heqim nga analiza të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Një analizë më e hollësishme për performancën e bashkive në mbledhjen e të ardhurave në vitin 2016 dhe krahasimet me vitet e mëparshme mund të ndërtohet mbi bazën e tabelës nr. 1 në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij raport. Tabela nr. 1 paraqet të ardhurat e veta vendore për periudhën 2012-2016, në milion lekë; të ardhurat për banor për dy vitet e fundit; dhe normën e rritjes së të ardhurave në vitin 2016 duke përdorur dy përkufizime të të ardhurave të veta vendore (në njërin prej të cilëve eliminohet efekti i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja). Të dhënat e bashkive dhe komunave për periudhën 2011-2015 janë konsoliduar sipas ndarjes së re administrative dhe territoriale për të evidentuar performancën e 61 bashkive të reja në krahasim me vitet e mëparshme. E thënë ndryshe, të dhënat janë konsoliduar për të bërë të mundur krahasimin e 61 bashkive në kohë.


**Nga sa lartpërmendur, është e rëndësishme që politikëbërësit vendorë dhe qendrorë të hulumtojnë dhe të konsiderojnë arsyet përse në disa nga bashkitë më të mëdha të vendit të ardhurat kanë rënë mesatarisht me 5% në krahasim me vitin 2015, si dhe përse në bashkinë e dytë më të madhe në vend, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore mbetën të pandryshuara krahasuar me vitin e mëparshëm. Kjo analizë është e domosdoshme në kushtet kur përmirësimi i administrimit fiskal në territorin e ish-komunave ka qenë një ndër objektivat kryesorë të reformës administrative dhe territoriale (RAT). Bashkitë më të mëdha të vendit pritej të kishin një rritje të fortë të të ardhurave të veta për arsye të shtimit të bazës së taksueshme nga territoret e ish-komunave dhe ekzistencës së supozuar të një administratë fiskale më eficiente së në bashkitë e vogla apo ish-komunat. Ndërkohë, vlerësohet që hapësirat për përmirësim në bashkitë e vogla dhe të mesme të jenë të mëdha.**

### 3.5 Sa kanë paguar Tatimpaguesit për Taksat dhe Tarifat Vendore?

Të ardhurat e bashkive nga taksat dhe tarifat vendore në vitin 2016 ishin 16.8 miliard lekë ose 123.4 milion Euro, me një rrije prej vjetore 3.7 miliardë lekë (ose 27.5 milion Euro). Megjithëse mund të jetë një nga arsyet kryesore, rritja e të ardhurave të bashkisë nuk nënkupton detyrimisht rritje të barrës fiskale për tatimpaguesit. Një pjesë e mirë e rritjes së të ardhurave mund të vijë nga zgjerimi i bazës së taksueshme (numri e personave dhe bizneseve që përbushin detyrimet e tyre fiskale ndaj bashkisë) apo mbledhjes së borxheve tatimore. Për të nxjerrë konkluzione shteruese mbi barrën fiskale ndaj tatimpaguesve nevojitet një analizë rast pas rasti për çdo bashki duke analizuar nivelet e taksimit dhe tarifave të përzgjedhura dhe duke i krahasuar ato me bashkitë e tjera. Në këtë raport do të kufizohemi në një analizë të detyrimeve tatimore vjetore për banorë të paguara në vitin 2016. Megjithatë, platforma

5. Në të njëjtën kohë, vënia në dispozicion në platformë e të ardhurave faktike të mbledhura nga bashkia përkundrejt buxheteve të miratuara, lehtëson dhe mundëson një monitorim periodik të performancës të bashkisë në mbledhjen e të ardhurave.



**Grafiku 9:** Detyrimet tatimore vjetore për banor të paguara në vitin 2016, në lekë dhe euro.

**Burimi:** [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.


[www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al) mundëson analiza të thelluara duke vënë në dispozicion vendimet e këshillave bashkiakë për nivelet e taksave dhe tarifave dhe të ardhurat e planifikuara për tu mbledhur sipas dokumenteve të buxhetit.

Grafiku 9 tregon sa kanë paguar taksapaguesit për taksat dhe tarifave vendore në vitin 2016, të shprehura “për banorë”, në lekë dhe në Euro.

Për taksën e pasurisë së paluajtshme (ndërtesat dhe toka bujqësore), tarifave të shërbimeve (për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve, pastrimin, gjelbërimin dhe ndriçimin publik) dhe tarifave administrative, detyrimi tatimor i paguar për frymë është 3,451 lekë në vit (25.4 Euro), ose 9,5 lekë në ditë (0.07 Euro). Po ashtu, të ardhurat për frymë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë janë 951 lekë ose 7 Euro në vit; të ardhurat për frymë nga taksat dhe tarifave të tjera janë 1,392 lekë ose 10.2 Euro në vit. Nga ky grup i fundit mund të nxjerrim në pah të taksën e fjetjes në hotel, ku të ardhurat e mbledhura përgjatë gjithë vitit 2016 në të gjithë hotelet e Shqipërisë ishin vetëm 150 milion lekë (rreth 1.1 milion Euro), të cilat përkthehen në 52 lekë ose 0.4 Euro për banor. **Në përfundim, nga të dhënat për të ardhurat për frymë, rezulton se çdo qytetar shqiptar do të paguante rreth 5,795 lekë (ose 42.6 Euro) në vit në formën e taksave dhe tarifave vendore, që janë rreth 16 lekë (ose 0.12 Euro) në ditë.** Mesatarisht dhe pa marrë në konsideratë diferencat ligjore në trajtimin e taksave në qytete të ndryshme, rezulton se për një familje me katër pjesëtarë, detyrimi tatimor do të ishte rreth 23 mijë lekë në vit ose 170 euro në vit, pra pothuajse sa një pagë mujore minimale. Qartësisht familjet shqiptare nuk paguajnë nivele të tilla për taksat dhe tarifave vendore, duke bërë që pjesa më e madhe e barrës fiskale të bjerë mbi tatimpaguesit biznese.

### 3.6 Transfertat Ndërqeveritare dhe të Kushtëzuara

Transfertat e kushtëzuara nga qeverisja qendrore në vitin 2016 ishin rreth 12 miliardë lekë, ose 11% më shumë se në vitin 2015. Grafiku 10 tregon strukturën e transfertave të kushtëzuara për qeverisjen vendore në 6 vitet e fundit. Sikurse mund të evidentohet, financimet nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) për infrastrukturën publike dhe atë të transportit rrugor vendor zënë edhe peshën kryesore të totalit të transfertave. Transfertat nga FZHR për infrastrukturën janë rritur ndjeshëm në katër vitet e fundit, duke regjistruar një rritje vjetore prej 42% në raport me vitin 2015. Grupi i dytë më i madh i transfertave të kushtëzuara janë ato nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), të cilat shfaqin një luhshmëri shumë të vogël ndër vite. Është


**Grafiku 10:** Struktura e transfertave e kushtëzuara, krahasimi në vite, në miliard lekë.

**Burimi:** www.financatvendore.al, llogaritje të autorit.

e rëndësishme të specifikohet se në transfertat nga MAS dhe MTI përfshihen jo vetëm fondet e vëna në dispozicion të bashkive nga buxheti i vetë ministrive por edhe ato që kanalizohen në nivel vendor nga FZHR në këto ministri. E thënë ndryshe, përtej subvencioneve që jepen nga dy ministritë për arsimin dhe për sektorin e ujësjellës kanalizimeve, pjesa më e madhe e fondeve që shkojnë në nivel vendor nga këto ministri, në fakt financohen nga FZHR.

Ministritë e tjera që transferojnë fonde në nivel vendor për funksione të deleguara apo për funksione për të cilat si qeverisja qendrore ashtu edhe ajo vendore ndajnë përgjegjësi, janë: Ministria e Punëve të Brendshme për Zyrat e Gjendjes Civile dhe Emergjencat Civile; Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Kulturës, Ministria e Mjedisit, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë etj. Të gjitha së bashku këto ministri kanë transferuar në nivel vendor rreth 1.4 miliard lekë, ku sërish një pjesë financohet nga FZHR. Evidentohet se **përkundër faktit se infrastruktura publike vendore, infrastruktura e transportit, mirëmbajtja e institucioneve të arsimit, furnizimi me ujë dhe menaxhimi urban janë funksione ekskluzive vendore që do duhej të financoheshin me fondet e veta të bashkive, apo me fonde të cilat ato mund ti përdorin lirisht, në fakt, financohen me transfertat të kushtëzuara dhe me bazë konkurruese nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. E thënë ndryshe, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve mbetet burimi kryesor i financimeve të projekteve të investimeve vendore.**

Fakti që pjesa më e madhe e investimeve për funksionet ekskluzive vendore financohen nga qeverisja qendrore, ka ngritur debate të mëdha në raport me mënyrën se si përzgjidhen projektet që do të financohen, dhe në mjaft raste, në kohë të ndryshme bashkitë kanë ngritur shqetësime mbi kriteret dhe transparencën e këtyre proceseve, dhe eventualisht favorizimeve politike. Një analizë e thelluar në këtë drejtim, nuk është në fokusin e këtij raporti. Megjithatë, duke parë të dhënat për vitin 2016, evidentojmë se ka diferencë të mëdha në shumat e transfertave të kushtëzuara të dhëna për 61 bashkitë e reja. Grafiku 11 tregon shpërndarjen për banorë të transfertave të kushtëzuara nga FZHR, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës në vitin 2016. Megjithatë, analiza tregon se transfertat e kushtëzuar për banorë variojnë nga një maksimum prej rreth 40,000 lekë në një minimum prej 156 lekë

**Grafiku 11:** Transfertat e kushtëzuara për banorë, viti 2016

Burimi: [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.


për banor. Bashkia Kamëz, është e vetmja bashki që nuk ka marrë transfertat të kushtëzuara në vitin 2016. Sigurisht që analiza e një viti të vetëm nuk mjafton për nxjerrë konkluzione shteruese në lidhje me mënyrën e alokimit të fondeve të kushtëzuara. Gjithashtu duhet specifikuar se fondet lidhen me projekte specifike të përzgjedhura, të cilat sigurisht që kanë vlera të ndryshme në bashki të ndryshme. Megjithatë, është e rëndësishme që politikëbërësit të kenë në vëmendje këto diferencat dhe të sigurohen që ato të adresohen për vitet në vijim.

**Në Grafikonin A4, në Aneksin nr. 2 që i bashkëlidhet këtij raporti, paraqiten fondet e transferuara nga qeverisja vendore për bashkitë në vitin 2016.**

## 4 SHPENZIMET E QEVERISJES VENDORE

### 4.1 Ku Shkojnë Paratë: Si i shpenzuan Fondet Bashkitë në vitin 2016?

Ky seksion paraqet një analizë të shpenzimeve të 61 bashkive. Me fjalë të tjera, ky seksion tenton të ofrojë një tablo të qartë se si dhe ku shpenzohen paratë e taksapaguesve apo transfertat ndërqeveritare, dhe se si dhe ku shpenzohen

**Grafiku 12:** Shpenzimet vendore sipas burimit të financimit dhe natyrës ekonomike.

Burimi: [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

më shumë qeveria qendrore në nivel vendor. E thënë ndryshe, do të ofrojmë një analizë të shpenzimeve duke ndjekur natyrën ekonomike të shpenzimeve (p.sh. pagat e personelit, investimet etj.) dhe më pas sipas funksioneve të qeverisë (arsimit, infrastrukturës, shërbimet publike etj.). Gjithashtu do të ndajmë shpenzimet sipas burimeve të financimit dhe më pas do të fokusohemi në sektorët ku qeveria vendore investon më shumë.

Grafiku nr. 12 tregon se si janë shpenzuar fondet publike vendore në vitin 2016. Grafiku i parë majtas tregon shpenzimet sipas burimit të financimit; grafiku në mes tregon strukturën e shpenzimeve (sipas natyrës ekonomike) të financuara me burimet e veta të bashkisë (nëpërmjet të ardhurave të veta vendore, transfertave të pakushtëzuara, taksave të ndara, transfertave specifike për funksionet e decentralizuara rishtazi dhe fondet e mbartura nga vitet e mëparshme); dhe grafiku në të djathtë tregon shpenzimet (sipas natyrës ekonomike) të financuara me transfertat të kushtëzuara.

**Në fund të vitit 2016, shpenzimet totale vendore ishin 48.7 miliard lekë , nga të cilat 36.6 miliard lekë<sup>7</sup> ose 75% e totalit janë financuar nga burimet e veta të bashkisë<sup>8</sup>, ndërsa 12.1 miliard lekë, ose 25% janë financuar me transfertat të kushtëzuara nga qeverisja qendrore. Grafiku i mesit tregon se, nga shpenzimet e financuara nga vetë bashkitë, 15.6 miliard lekë ose 43% e totalit kanë shkuar për personelin; rreth 10 miliard lekë ose 27% kanë shkuar për shpenzimet operative të funksionimit të bashkisë (materiale zyre, ngrohje, karburant, shpenzime transporti, shpenzime për funksionimin e çerdheve dhe kopshteve, shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme etj.); ndërkohë 28% e fondeve (10.1 miliard lekë) janë përdorur për investime publike. Subvencionet dhe transfertat ndaj njëjësive/ndërmarrjeve në pronësi të bashkisë apo ndaj familjeve në nevojë zënë 2% të totalit të fondeve (846 milion lekë).**


Grafiku i tretë tregon se 81% e transfertave të kushtëzuara nga qeveria qendrore (ose 9.8 miliard lekë) kanë shkuar për investime, ndërsa një pjesa tjetër ka shkuar për shpenzime korrente për funksionet e deleguara (zyrat e Gjendjes Civile, zyrat e Qendrave Kombëtare të Biznesit, Qendra Sociale etj.), subvencione për ndërmarrjet e ujësjellësit dhe për shpenzime të tjera operative të financuara nga qeverisja qendrore.

## 4.2 Krahasimi me Vitet e Mëparshme: A Janë Rritur Shpenzimet Vendore?

Një ndër synimet kryesore të Reformës Administrative dhe Territoriale (RAT) ishte ulja e shpenzimeve administrative dhe operacionale nga reduktimi i numrit të njëjësive të qeverisjes vendore nga 373 komuna dhe bashki në vetëm 61 bashki. Pritej që këto kursime do të mund të përdoshin më pas për më shumë investime publike nga vetë bashkitë. Analiza në vijim na ndihmon për të kuptuar më mirë performancën e bashkive në raport me këto pritshmëri. Paraprakisht, duhet të mbahet në konsideratë një element i rëndësishëm që ka ndikuar në shpenzimet administrative të vitit 2016, që është, transferimi i një sërë funksionesh të reja nga qeveria qendrore tek bashkitë. Transferimi i funksioneve u shoqërua me transferimin e personelit dhe shpenzimeve përkatëse (për paga dhe të funksionimit) nga ministrinë që deri në fund të vitit 2015 ishin përgjegjëse për funksionet. Fondet e alokuara nëpërmjet Ligjit të Buxhetit Vjetor 2016, për funksionet e reja ishin rreth 5.7 miliard lekë. Grafiku 13, tregon strukturën e shpenzimeve të veta vendore sipas natyrës ekonomike në 6 vitet e fundit. Analiza do duhet të kryhet në nivel agregat (shpenzime

7. Duhet të mbahet në konsideratë se një pjesë e shpenzimeve vjetore të bashkive financohen me fonde të disponueshme të mbartura nga vitet e mëparshme. Në rastin konkret, në vitin 2016, fondet që 61 bashkitë e reja kanë mbartur nga viti 2015 kanë qenë rreth 2.1 miliard lekë.

8. Burimet e veta në këtë rast, përfshijnë edhe shpenzimet për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor. Kjo sepse në sistemin e thesarit, si transfertat e pakushtëzuar si ato specifike regjistrohen në të njëjtën llogari ekonomike, duke e bërë të pamundur ndarjen e tyre përsa i përket fondeve faktike. Një mënyrë për të bërë një vlerësim të ndarjes së transfertave specifike, është të konsiderohet vlera e planifikuar për tu alokuar në Ligjin Vjetor të Buxhetit, me supozimin që janë transferuar 100%, dhe shuma më pas të zbritet nga totali i transfertave të regjistruara në llogarinë ekonomike të përdorur për transfertat e pakushtëzuar dhe atë specifike.

**Grafiku 13:** Struktura e shpenzimeve të veta vendore sipas natyrës ekonomike, në miliard lekë.

**Burimi:** [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

për paga dhe operative së bashku) për të bërë të mundur krahasim para dhe pas transferimit të funksioneve të reja. Në vitin 2016, shpenzimet e personelit dhe ato operative kanë qenë 25.6 miliard lekë, nga të cilat 5.7 miliardë janë transfertat specifike për funksionet e reja. Nëse heqim efektin e funksioneve të reja, shpenzimet e personelit dhe ato operative në fund të vitit 2016 janë rreth 19.9 miliard lekë, ose rreth 2.4% (460 milion lekë) më të larta se ato në fund të vitit 2015, ose 0.9% (174 milion lekë) më të larta se viti 2014. Kjo rritje e vogël e shpenzimeve për pagat e personelit dhe të funksionimit mund të vijë si pasojë e disa rrethanave. Nga njëra anë, mund të tregojë se fondet e vëna në dispozicion nga qeveria qendrore nëpërmjet transfertave specifike nuk kanë qenë të mjaftueshme për financimin e funksioneve të reja dhe bashkitë kanë shtuar financimet për këto funksione nga fondet e veta. Nga ana tjetër, nëse supozojmë se reforma administrative territoriale ka sjellë një reduktim të personelit dhe shpenzimeve përkatëse, do të rezultonte se të gjitha këto kursime mund të kenë shkuar për të financuar funksionet e reja. Një tjetër alternative mund të jetë fakti se bashkitë as nuk kanë shtuar fondet për funksionet e reja, dhe as nuk kanë shkurtuar shpenzimet e tyre administrative.

Një tjetër pritshtëri e reformës administrative dhe territoriale ishte rritja e investimeve publike nga bashkitë, ose më saktësisht rritja e peshës së investimeve në buxhetet vendore. **Në vitin 2016, shpenzimet e veta të bashkive për investime publike ishin 10.2 miliard lekë, 2.2 miliard lekë ose 26% më shumë se në vitin 2015.** Ndërkohë që ka një rritje të fortë të shpenzimeve për investime, duket sikur kjo rritje është më e vogël se rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të cilat janë rritur me 3.7 miliard lekë. E thënë ndryshe, **rritja e të ardhurave vendore në vitin 2016 është transferuar vetëm pjesërisht tek investimet e financuara nga veta bashkitë.**

Nxjerrja e konkluzioneve mbi efektet dhe pritshmëritë e reformës administrative dhe territoriale është jashtë fokusit të këtij raporti, dhe në çdo rast, të dhënat e një viti të vetëm nuk mjaftojnë për të nxjerrë konkluzione shteruese.

Megjithatë nga të dhënat e analizuar për vitin 2016 mund të themi se, **në vitin e parë të plotë të zbatimit të reformës administrative dhe territoriale, ka një rritje të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore me 28% e cila është përkthyer në një rritje të shpenzimeve për investime publike me 26% në terma vjetorë. Përsa i përket shpenzimeve administrative të personelit dhe atyre operative, nuk evidentohet një ulje sikurse pritej nga reduktimi i numrit të njësisive të vetëqeverisjes vendore nga 373 komuna dhe bashki në vetëm 61 bashki. Duke marrë në konsideratë faktin e transferimit të funksioneve të reja dhe kuadrin ligjor për marrëdhëniet e punësimit dhe statusin e nëpunësit civil, vlerësohet se do duhet më shumë kohë për të parë kursimet e pritura nga konsolidimi territorial.**


### 4.3 Diferencat Ndërmjet Bashkive në Strukturën e Shpenzimeve

Ekzistojnë diferenca të forta ndërmjet bashkive përsa i përket strukturës së shpenzimeve. Një mënyrë e mirë për të parë këto diferenca është krahasimi i shpenzimeve për banorë dhe i peshës së kategorive të ndryshme të shpenzimeve në buxhetin e bashkisë.

Grafiku A2 në Aneksin nr. 2, që i bashkëlidhet këtij raporti tregon se, **në vitin 2016, shpenzimet administrative të bashkive për personelin variojnë nga 3,000 deri në 13,700 lekë për banor; shpenzimet operative variojnë nga 1,200 deri në 12,500 lekë për banor, ndërkohë që shpenzimet për investime variojnë nga 500 deri në 9,700 lekë për banorë.**

Aneksi nr. 1 që i bashkëlidhet këtij raporti, evidenton gjithashtu diferenca të theksuara ndërmjet bashkive përsa i

**Grafiku 14:** Shpenzimet për banorë në raport me madhësinë e bashkisë, viti 2016.



Burimi: [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.




përket peshës së shpenzimeve për personelin, operative dhe investimet në buxhetet vendore. Në 61 bashkitë e reja, në vitin 2016, shpenzimet për personelin përbëjnë 30%-70% të shpenzimeve të veta vendore; shpenzimet operative përbëjnë 13 - 46%; dhe investimet përbëjnë 5% deri në 55% të buxheteve të veta të bashkive.

Në të njëjtën mënyrë, ekzistojnë diferenca të thella ndërmjet bashkive përsa i përket normës së rritjes vjetore të investimeve në vitin 2016. Aneksi nr.1 dhe Tabela nr. 2, në Aneksin nr. 2 tregon pikërisht nivelin e investimeve për frymë, për periudhën 2012-2016 dhe rritjen e shpenzimeve për investime investimeve në vitin 2016, duke evidentuar se: në 19 nga 61 bashkitë e reja, shpenzimet për investime kanë rënë nga -2 deri në -60% në raport me vitin 2015; në 22 bashki të tjera, shpenzimet për investime janë rritur me 1-90% në terma vjetorë ndërkohë që në 20 bashki të tjera investimet janë rritur me më shumë se 120%.

Për të kuptuar nëse këto diferenca lidhen me madhësinë e bashkisë kemi analizuar shpenzimet vendore për personelin, operativet dhe investimet në raport me madhësinë e bashkisë dhe i kemi paraqitur në grafikun nr. 14. Për hir të analizës grafike, janë hequr nga analiza të dhënat për dy bashkitë më të mëdha të vendit dhe dy më të voglat.

Sikurse evidentohet, në fund të 2016, shpenzimet për frymë për pagat e personelit, përgjithësisht janë më të larta në bashkitë e vogla; shpenzimet operative kanë një shpërndarje më uniforme në raport me madhësinë e bashkisë. Ndërkohë, shpenzimet për investime nuk duket të lidhen me madhësinë e bashkisë. Sikurse pritej shpenzimet për

**Grafiku 15:** Investimet sipas funksioneve dhe burimit të financimit në 2016, në % ndaj totalit.



**Burimi:** [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

investime janë pothuajse gjithmonë më të ulta se shpenzimet për personelin dhe ato operative. Në vetëm 6 raste shpenzimet për frymë për investime janë më të larta se shpenzimet për personelin, dhe në 3 nga këto 5 raste bëhet fjalë për bashki me popullsi mesatare midis 20-30.000 banorë.


#### 4.4 Ku Shkojnë Paratë: Ku Fokusohen Investimet Publike Vendore?

Në seksionin e mëparshëm u evidentua se shpenzimet për investime të financuara nga vetë bashkitë në vitin 2016 ishin 10.2 miliardë lekë ose 26% më të larta në krahasim me vitin 2015. Në të njëjtën kohë, transfertat e kushtëzuara nga qeverisja qendrore për investime ishin rreth 9.7 miliard lekë, ose 15% më shumë se në vitin 2015. Është e rëndësishme të analizohet se në cilët sektorë fokusohen investimet e financuara nga vetë bashkitë dhe në cilët sektorë investon më shumë qeverisja qendrore në nivel vendor. Për këtë vjen në ndihmë grafiku 15. Pjesa e majtë e

grafikut tregon investimet e financuara nga vetë bashkitë ndërsa grafiku në të djathtë tregon investimet e financuara me transferata të kushtëzuara nga qeveria qendrore.

Në vitin 2016, 59% e investimeve të vetë bashkive u fokusuan në infrastrukturë publike e sidomos atë të transportit,

**Grafiku 16:** Investimet sipas funksioneve dhe burimit të financimit, 2011-2016, në miliard lekë.




**Burimi:** [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

22% në përmirësimin e shërbimeve publike vendore si psh., ujësjellës-kanalizimet, pastrimi i qytetit, ndriçimi publik, gjelbërimi etj.; 10% në funksionet e administratës si p.sh., përmirësimi i kushteve të administratës; 7% për sistemin e arsimit parauniversitar si p.sh., kopshtet dhe çerdhet dhe mirëmbajtjen e shkollave të mesme dhe konvikteve; ndërkohë që vetëm 2% janë dedikuar për funksionet e kulturës, mbrojtjes sociale dhe shëndetësisë. Në funksionet e mbrojtjes së mjedisit dhe rendit dhe sigurisë publike nuk ka të regjistruara shpenzime, ndonëse të gjitha bashkitë kanë drejtori për mbrojtjen e mjedisit dhe policinë bashkiake, duke treguar kështu për mundësinë e ekzistencës së problemeve të raportimit financiar dhe aftësisë për të planifikuar mbi bazën e programeve buxhetore. Në përfundim, në vitin 2016, 81% e investimeve publike të financuara nga vetë bashkitë shkojnë për infrastrukturën dhe shërbimet publike, ndërkohë që investimet për funksionet e arsimit janë më të ulta se investimet për përmirësimin e kushteve të punës të administratës.

Për të kuptuar më mirë se cilët janë sektorët që kanë përfutur më shumë nga rritja e investimeve të financuara nga vetë bashkitë dhe qeverisja qendrore, vjen në ndihmë grafiku 16, i cili paraqet shpenzimet për investime sipas funksioneve dhe burimit të financimit për periudhën 2011-2016.

Ndërkohë që në vitet 2011-2013, investimet në infrastrukturë të financuara nga vetë bashkitë ishin më të larta se ato të financuara nga qeverisja qendrore, në tre vitet e fundit evidentohet se këto janë pothuajse në të njëjtat nivele, duke treguar kështu një interes të fortë të qeverisjes qendrore për punët publike në nivel vendor. Për vitin 2016, investimet në fushën e infrastrukturës publike të financuara nga qeveria qendrore nëpërmjet programeve të rikualifikimit urban janë 600 milion lekë më të larta se ato të vetë bashkive. Në të njëjtën kohë, evidentohet se kapaciteti i qeverisjes vendore për investimet e nevojshme në funksionet e arsimit mbetet i kufizuar dhe shumë më i ulët se financimet e qeverisjes qendrore. Thënë ndryshe, qeverisja qendrore mbetet financuesi kryesor i mirëmbajtjes së kopshteve, çerdheve dhe shkollave, ndonëse ky është një funksion ekskluziv vendor.




**Grafiku 17:** Shpenzimet sipas funksioneve dhe burimit të financimit në 2016, në % ndaj totalit.

Burimi: [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

#### 4.5 Ku Shkojnë Paratë: Në cilat Funksione Shpenzohen Fondet?

Në këtë seksion paraqitet një analizë e të gjithë shpenzimeve të ndara sipas funksioneve kryesore të qeverisjes dhe burimit të financimit. Pjesa në të majtë të grafikut 17 tregon shpenzimet e financuara nga vetë bashkitë ndërsa pjesa në të djathtë tregon shpenzimet e financuara me transferta të kushtëzuara.

**Në vitin 2016, bashkitë kanë dedikuar mesatarisht 26% të buxheteve të tyre për shërbimet e**

**Grafiku 18:** Investimet sipas funksioneve dhe burimit të financimit, 2011-2016, në miliard lekë.

Burimi: [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al), llogaritje të autorit.

**përgjithshme administrative (pra administratën e bashkisë), 21% të fondeve për infrastrukturën publike (sidomos transportin), 21% për shërbimet publike të largimit të mbetjeve, pastrimit, ndriçimit publik, gjelbërimit etj.; 17% për kopshtet, çerdhjet dhe arsimin 9-vjeçar; 5% për sportin dhe kulturën; 3% për funksionimin e qendrave sociale për njerëzit në nevojë; 3% për mirëmbajtjen e shkollave të mesme; nga 1% për furnizimin me ujë dhe shërbimet e strehimit; ndërkohë që nuk rezultojnë të ketë shpenzime të regjistruara për programet e rendit dhe sigurisë publike, shëndetësisë dhe mbrojtjes së mjedisit,**

ndonëse bashkitë kanë kompetenca ekskluzive për secilin nga këto funksione. Pjesa e djathtë e grafikut eidenton se **fokusi i qeverisjes qendrore në financimet e dhëna për bashkitë mbetet infrastruktura publike, arsimit, mbrojtja sociale, furnizimi me ujë dhe kanalizimet.**

Grafiku nr. 18 paraqet krahasimin e shpenzimeve sipas funksioneve në vitet 2011-2016, duke dhënë kështu mundësinë për të bërë krahasimet para dhe pas reformës administrative dhe eidentimin e ndryshimeve eventuale në strukturën e shpenzimeve si pasojë e funksioneve të reja apo ndryshimeve në politikën fiskale dhe buxhetore të bashkive të reja. Pjesa e majtë e grafikut tregon ecurinë e shpenzimeve të financuara me fondet e vetë bashkive, ndërkohë që pjesa e djathtë shpenzimet e financuara me transferta të kushtëzuara.

Ndërkohë që sipas analizës së shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik, rezultonte se në vitin 2016, **shpenzimet për pagat e personelit janë rritur me 2.4% në krahasim me vitin 2015, grafiku 18 tregon se shpenzimet e përgjithshme për aparatin qendror administrativ kanë rënë me 5% në terma vjetorë. Shpenzimet e përgjithshme për infrastrukturën dhe shërbimet publike janë rritur përkatësisht me 26% dhe 11% në krahasim me vitin 2015; shpenzimet e përgjithshme për sportin dhe kulturën janë rritur me 22% dhe shpenzimet për furnizimin me ujë dhe kanalizimet janë rritur me 9%.**

Në të njëjtën kohë, **shpenzimet për funksionet e arsimit parashkollor dhe fillor dhe ato të sistemit të arsimit të mesëm janë rritur respektivisht me 218% dhe 184% në raport me vitin 2015, duke konfirmuar edhe një herë që rritja e shpenzimeve të personelit është e lidhur me funksionet e reja.** Nga të dhënat në sistemin e thesarit nuk rezulton e qartë se në cilat programe buxhetore janë regjistruar shpenzimet për funksionet e tjera të reja si ato të mbrojtjes nga zjarri, pyjeve dhe kullotave, ujitja dhe kullimi etj. Ndoshta një pjesë e tyre është përfshirë në zërat e infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

Krahu i djathtë i grafikut, **eidenton se shpenzimet e qeverisjes qendrore për infrastrukturën publike vendore janë rritur në mënyrë progresive, duke treguar kështu një interes gjithnjë e më të madh në funksionet vendore. Nga ana tjetër, transfertat e përgjithshme të kushtëzuara për funksionet e arsimit, sportit, mbrojtjes sociale dhe furnizimit me ujë dhe kanalizimet mbeten pothuajse në të njëjtat nivele me vitet e mëparshme. Në vitin 2016, shpenzimet për infrastrukturën publike të financuara nga qeverisja qendrore janë rritur me 41% në krahasim me vitin 2015.** Rritja e financimeve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është mirëpritur nga një pjesë e bashkive ndërkohë që është parë me skepticizëm nga mjaft bashki të tjera, të cilat ngrenë zërin për më shumë transparencë në mënyrën e ndarjes së fondeve të investimeve nga FZHR.

## 5 Vërejtje Përfundimtare mbi Financat Vendore në Fund të Vitit të Parë të Reformës Administrative dhe Territoriale

Pas Reformës Administrative Territoriale, Strategjisë së Decentralizimit dhe Ligjit të ri për Vetëqeverisjen Vendore, decentralizimi fiskal dhe mjaftueshmëria e burimeve financiare vendore mbetet një nga çështjet kryesore që duhet të zgjidhet nga autoritetet shqiptare. Nga perspektiva e qeverisjes vendore, megjithëse në vitin 2016 eidentohet një përmirësim në nivel agregat i gjendjes financiare të bashkive, në nivel individual bashkitë shfaqin diferenca të theksuara përsa i përket kapacitetit fiskal, mundësisë për të financuar investime strategjike dhe varësisë nga transfertat e qeverisjes vendore.

Ndryshimet e shpeshta në kuadrin ligjor që rregullon të ardhurat e veta të bashkive nga taksat dhe tarifatat janë shoqëruar me efekte të kontradiktore në financat vendore. Ndërkohë që ndryshimet në kuadrin ligjor për taksën e zënies së hapësirës publike, të tabelave dhe fjetjes në hotel kanë sjellë një rritje të të ardhurave vendore me rreth 500 milion lekë në vitin 2016, ndryshimet dhe zvogëlimi i kompetencave të bashkive mbi tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël i ka kushtuar bashkive rreth tre herë më shumë, duke humbur 1.5 miliard lekë në vitin 2016. Në të njëjtën të ardhurat nga taksat e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja, edhe pse në rritje të fortë në krahasim me vitin e kaluar vazhdojnë të mbeten larg niveleve të viteve para vendosjes së moratoriumit të lejeve për ndërtime të reja apo rënies së aktivitetit ekonomik në përgjithësi.

Pritet që taksat mbi pasurinë e paluajtshme të marrë një rëndësi edhe më të madhe me reformën e saj dhe ndërtimin e kadastrës apo regjistrin fiskal të premtuar prej shumë vitesh nga qeveria qendrore. Megjithatë, mbetet ende e paqartë strategjia dhe plani i veprimit për reformën në taksën mbi pasurinë e paluajtshme. Nëse fokusohemi në strukturën e kësaj takse, në vitin 2016, si viti i parë i zbatimit të reformës administrative dhe territoriale të ardhurat nga taksat mbi tokën bujqësore janë rritur me vetëm 184 milion lekë duke treguar se do duhet më shumë kohë për të parë përmirësimet të ndjeshme të të ardhurave vendore nga bashkitë e reja në territorin e ish-komunave.

Reforma Administrative dhe Territoriale pritej të shoqërohet me një ulje të kostove administrative si pasojë e konsolidimit të 373 njësive të fragmentuara të qeverisjes vendore në vetëm 61 bashki dhe një rritje të shpenzimeve për investime publike. Analiza jonë tregon se në nivel agregat, në vitin 2016, duke mënjanuar efektin e transferimit të funksioneve të reja, shpenzimet për pagat e personelit dhe ato operative të 61 bashkive nuk janë ulur, por janë rritur me rreth 2.4% në krahasim me vitin e mëparshëm. Megjithatë evidentohen diferenca të theksuara ndërmjet bashkive përsa i përket ndryshimit në kostot administrative. Kjo mund të justifikohet me nevojën për shtimin e fondeve për funksionet e reja që iu janë transferuar bashkive, me kufizimet në mundësinë e shkurtimit të kostove të personelit të diktuar nga kërkesat e Kodit të Punës apo Ligjit për Shërbimin Civil apo edhe me preferencat e bashkive për të mos ulur numrin e të punësuarve. Sigurisht që do duhet kohë për të parë përfitimet nga konsolidimi territorial, dhe analiza e një viti të vetëm nuk është e mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione shteruese. Megjithatë është e rëndësishme të nënvizohet se edhe nëse kursime do të kishte, ato nuk do të zgjidhnin problemin e mungesës së fondeve për financimin e funksioneve apo investimeve publike. Analiza jonë tregon që ndryshe nga sa pritej, në të paktën 5 nga 10 bashkitë më të mëdha të vendit, të ardhurat nga taksat dhe tarifatat janë të njëjta ose më të ulta se në vitin 2015 apo në vitet e mëparshme, duke dobësuar më tej pritshmërinë e efekteve pozitive të menjëhershme nga bashkitë e mëdha të cilat mendoj se kishin kapacitetet e nevojshme administrative dhe menaxheriale për të administrimin fiskal. Kjo nënkupton që pavarësisht madhësisë, të gjitha bashkitë e reja do të duhet të investojnë burime të konsiderueshme dhe kohë për zhvillimin e sistemeve menaxheriale për administrimin fiskal në territoret e reja më të gjëra.

Një tjetër pritshmëri e rëndësishme nga Reforma Administrative Territoriale është rritja e shpenzimeve të bashkive për investime publike. Analiza tregon se investimet publike të financuara nga vetë bashkitë janë rritur me 26% në krahasim me vitin 2015, duke reflektuar kështu pjesërisht rritjen e të ardhurave vendore. Por edhe në këtë rast ekzistojnë diferenca ndërmjet bashkive, me 19 nga 61 bashkitë që kanë investuar nga 2 deri në 60% më pak se në vitin 2015. Kjo performancë nuk është e lidhur domosdoshmërisht me ecurinë e të ardhurave të veta, por mund të reflektojë dinamika të tjera të brendshme të bashkive si p.sh., nevoja për të subvencionuar me shpenzime korrente funksionet e reja, apo një ndryshim të preferencave për politikën e investimeve të veta vendore të cilat gjithnjë e më shumë financohen nga qeverisja qendrore. Dhe në fakt, rritja progresive e madhësisë së transfertave të kushtëzuara apo ato konkurruese nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, sidomos në tre vitet e fundit, mund të ketë ndikuar në deformimin e politikave fiskale vendore duke krijuar pritshmëri të gabuara që investimet bashkiake mund dhe duhet të financohen nga qeverisja qendrore. Në fakt, në 2016, në 37 nga 61 bashkitë, investimet e financuara nga qeveria qendrore janë nga 1 deri në 17 herë më të larta se investimet e financuara nga vetë bashkitë. Ky realitet tregon se

qeverisja qendrore vazhdon më mbajë një nivel të lartë kontrolli të aktiviteteve dhe zhvillimeve në nivel vendor, përkundër reformave decentralizuese.

Reforma territoriale nuk do të zgjidhë automatikisht mangësitë aktuale të parashikueshmërisë dhe transparencës së sistemit të transfertave ndërqeveritare. Ndërkohë që transfertat e pakushtëzuar vazhdon të mbetet burimi kryesor i financimit të më shumë se 50% të të ardhurave për 70% nga bashkitë e reja, ajo mbetet e paqëndrueshme në kohë si pasojë e mos-lidhjes me një variabël makroekonomike që do të siguronte stabilitet në kohë. Në të njëjtën mënyrë, analiza për vitin 2016 tregon për diferenca të theksuara në trajtimin e bashkive me transfertat të kushtëzuara nga qeverisja qendrore, me shuma që variojnë nga një maksimum prej rreth 40,000 lekë për banor në një minimum prej 156 lekë për banor, ndërkohë që bashkia Kamëz, nuk ka marrë asnjë transfertë të kushtëzuar nga ministritë apo Fondi për Zhvillimin e Rajoneve në 2016.


Mospërballja me këto sfida bart rrezikun e dështimit të qëllimeve strategjike të reformës administrative territoriale për më shumë dhe shërbime më të mira, qeverisje më të mirë dhe më eficiente, dhe zhvillim më të balancuar territorial dhe ekonomik.

Arritja e qëllimeve strategjike të Reformës a Territoriale, kërkon më shumë autonomi fiskale – pra burime të mjaftueshme për të planifikuar dhe menaxhuar ofrimin e shërbimeve publike lokale, sipas preferencave të qytetarëve pa ndërhyrje të tepërta dhe të vazhdueshme nga nivelet më të larta të qeverisjes. Nëse qeveritë vendore sigurojnë në mënyrë autonome sasi të konsiderueshme të të ardhurave nga juridiksionet e tyre, apo kanë më shumë liri në përcaktimin e prioriteteve dhe përdorimin e fondeve që vijnë nga qeveria qendrore në formën e transfertave, ka të ngjarë që Bashkitë do të bëhen subjekt i kërkesave në rritje të qytetarëve për llogaridhënie dhe do të përballen me kërkesa në rritje për pjesëmarrje në vendimmarrje për përdorimin e fondeve publike, çka do të sjellë më shumë eficiencë dhe efektivitet.


# ANEKSI 1

## Pesha specifike e burimeve të financimit të bashkive në vitin 2016 në përqindje ndaj totalit.


Të ardhurat nga Taksat dhe Tarifat Vendore në përqindje ndaj totalit të financimeve.



Shpenzimet për investime në përqindje ndaj totalit.




Shpenzimet e personelit në përqindje ndaj totalit.



# Norma vjetore e rritjes së të ardhurave, investimeve dhe shpenzimeve korrente (ndryshimi në përqindje në raport me vitin 2015).

Rritja Vjetore e të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore.



Rritja Vjetore e Investimeve.



Rritja e Shpenzimeve Korrente.







Tabela nr. 1: Të ardhurat 2012-2016; të ardhurat për banor dhe norma e rritjes vjetore.

Bashkitë sipas ndarjes së re administr.	Të ardhurat faktike, në milion lekë					Rritja e të ardhurave	Popullsia, Census 2011	Të ardhurat për banor		Rritja 2016/2015	Rritja pa taksën e ndik. në infrast.
	2012	2013	2014	2015	2016			2015	2016		
Belsh	20.2	13.2	22.3	18.9	78.3	59.4	19,503	969	4,012	314%	311%
Mal. e Madhe	41.2	26.5	59.5	40.8	128.8	88.0	30,823	1,324	4,180	216%	49%
Tropojë	24.3	65.0	29.8	35.6	86.1	50.5	20,517	1,734	4,196	142%	2%
Delvinë	24.5	21.7	24.2	20.8	46.4	25.6	7,598	2,738	6,103	123%	121%
Mallakastër	99.2	124.3	136.8	106.0	196.1	90.1	27,062	3,915	7,245	85%	129%
Mirditë	46.8	29.2	34.8	27.0	48.1	21.1	22,103	1,222	2,178	78%	15%
Cërrik	46.9	43.9	61.8	56.4	99.1	42.7	27,445	2,055	3,611	76%	59%
Klos	11.0	13.8	13.1	17.3	28.4	11.2	16,618	1,038	1,712	65%	16%
Finiq	49.4	37.8	58.6	32.7	51.4	18.7	10,529	3,107	4,879	57%	63%
Konispol	28.4	25.2	30.6	27.7	43.0	15.3	8,245	3,359	5,216	55%	60%
Fushë Arrëz	13.0	13.7	15.4	12.8	19.5	6.7	7,405	1,727	2,631	52%	51%
Maliq	48.7	40.7	56.3	55.2	82.1	26.9	41,757	1,323	1,967	49%	48%
Himarë	82.1	78.4	105.1	109.5	162.3	52.8	7,818	14,007	20,763	48%	26%
Tiranë	4,600.1	5,072.8	5,797.8	4,897.7	7,259.6	2,361.9	557,422	8,786	13,023	48%	37%
Libohovë	5.1	5.4	9.0	7.7	11.3	3.6	3,667	2,096	3,087	47%	38%
Krujë	153.3	166.0	175.9	186.5	268.8	82.3	59,814	3,118	4,493	44%	30%
Devoll	48.7	45.1	47.8	47.3	64.3	17.0	26,716	1,771	2,406	36%	27%
Skrapar	44.3	33.7	38.5	67.2	89.4	22.2	12,403	5,421	7,209	33%	10%
Selenicë	36.2	28.9	38.4	38.7	50.4	11.7	16,396	2,359	3,072	30%	32%
Korçë	375.6	305.2	499.0	422.2	548.8	126.6	75,994	5,556	7,221	30%	14%
Vorë	261.1	243.1	250.1	269.9	350.2	80.3	25,511	10,580	13,727	30%	-1%
Divjakë	76.9	58.9	80.9	72.1	92.9	20.8	34,254	2,105	2,712	29%	14%
Dropulli	31.2	29.4	34.1	37.6	48.4	10.8	3,503	10,739	13,810	29%	19%
Librazhd	50.9	42.7	45.9	60.5	77.1	16.7	31,892	1,896	2,418	28%	36%
Pogradec	167.4	139.1	151.2	149.6	189.9	40.3	61,530	2,431	3,086	27%	24%
Përrenjas	36.2	31.1	35.0	39.0	48.2	9.2	24,906	1,566	1,934	23%	8%
Memaliaj	9.9	7.3	10.8	13.8	16.9	3.2	10,657	1,292	1,590	23%	20%
Pukë	22.6	19.1	30.6	21.3	26.1	4.9	11,069	1,920	2,361	23%	-6%
Kamëz	369.0	362.6	341.2	408.5	499.5	91.0	104,190	3,921	4,794	22%	19%
Pustec	2.3	2.4	2.1	3.2	3.9	0.7	3,290	975	1,174	20%	20%
Vlorë	591.1	540.8	663.0	432.8	518.0	85.2	104,827	4,128	4,942	20%	19%
Lushnjë	246.1	198.3	258.8	282.1	336.8	54.7	83,659	3,372	4,026	19%	18%
Peqin	33.1	28.0	37.0	40.4	48.2	7.8	26,136	1,547	1,845	19%	14%
Kukës	54.5	58.0	63.3	77.4	92.0	14.6	47,985	1,613	1,918	19%	-2%
Kavajë	198.3	225.0	231.3	233.7	277.7	44.0	40,094	5,830	6,926	19%	-1%
Përmet	35.3	31.4	36.5	34.4	40.8	6.4	10,614	3,242	3,841	18%	16%
Tepelenë	15.4	16.5	15.0	17.9	21.1	3.2	8,949	1,997	2,353	18%	13%
Shijak	89.9	65.7	90.5	144.7	170.3	25.6	27,861	5,193	6,111	18%	6%
Polçan	26.7	28.7	32.3	36.0	42.1	6.1	10,953	3,287	3,844	17%	12%
Roskovec	128.3	130.8	164.2	153.4	179.3	25.8	21,742	7,056	8,245	17%	16%
Sarandë	314.8	231.1	303.5	229.2	267.5	38.3	20,227	11,331	13,223	17%	18%
Bulqizë	40.9	45.5	42.6	37.2	43.1	5.9	31,210	1,192	1,382	16%	13%
Patos	130.2	101.6	131.5	102.3	110.0	7.7	22,959	4,454	4,791	8%	-11%
Elbasan	445.4	474.8	766.8	507.2	545.4	38.3	141,714	3,579	3,849	8%	5%
Dibër	66.0	70.3	64.4	61.2	65.6	4.5	61,619	993	1,065	7%	1%
Kurbin	51.9	42.1	67.6	57.0	60.5	3.4	46,291	1,232	1,306	6%	-5%
Rrogozhinë	54.3	52.2	75.7	66.4	70.1	3.7	22,148	2,996	3,164	6%	4%
Shkodër	322.3	448.0	424.5	444.8	464.0	19.2	135,612	3,280	3,421	4%	11%
Vau Dejës	65.0	83.8	94.9	95.3	98.0	2.7	30,438	3,130	3,220	3%	30%
Gjirokastër	161.1	124.8	135.0	136.7	139.2	2.4	28,673	4,769	4,854	2%	-4%
Durrës	915.7	904.3	1,036.8	1,175.3	1,180.1	4.8	175,110	6,712	6,739	0%	-9%
Mat	37.2	42.1	49.5	49.8	49.7	(0.1)	27,600	1,803	1,800	0%	-16%
Has	9.8	9.4	11.4	12.0	12.0	(0.0)	16,790	718	716	0%	-2%
Lezhë	217.5	261.3	365.0	287.1	281.0	(6.2)	65,633	4,375	4,281	-2%	30%
Berat	197.9	208.4	246.6	267.1	257.9	(9.2)	60,031	4,449	4,296	-3%	-5%
Kuçovë	86.2	84.0	109.2	100.3	95.4	(4.9)	31,262	3,210	3,052	-5%	-10%
Kolonjë	34.6	30.8	34.9	37.2	35.3	(1.9)	11,070	3,363	3,190	-5%	-7%
Ura Vajg.	54.0	42.0	82.9	81.6	76.3	(5.4)	27,295	2,991	2,794	-7%	-11%
Fier	477.1	393.9	460.8	480.6	438.9	(41.7)	120,655	3,983	3,638	-9%	-12%
Këlcyrë	14.2	10.2	14.3	11.0	9.5	(1.5)	6,113	1,803	1,553	-14%	-13%
Gramsh	46.9	43.6	62.7	60.6	41.4	(19.2)	24,231	2,502	1,709	-32%	-35%
<b>Totali</b>	<b>11,988.3</b>	<b>12,153.5</b>	<b>14,409.4</b>	<b>13,056.1</b>	<b>16,782.2</b>	<b>3,726.1</b>	<b>2,800,138</b>	<b>4,663</b>	<b>5,993</b>	<b>28.5%</b>	<b>311%</b>


## ANEKSI 2

**Grafiku A2:** Struktura e shpenzimeve për banor në vitin 2016.



**Burimi:** [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al); Përlllogaritje të autorit.

**Grafiku A3:** Struktura e shpenzimeve sipas peshës specifike, 2016, në përqindje ndaj totalit.



**Burimi:** [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al); Përlllogaritje të autorit.



# Grafiku A4, Investime të financuara me transfertat të kushtëzuara nga qeverisja qendrore dhe investimet e financuara nga vetë bashkitë.

Transfertat e Kushtëzuara për Banorë.

Transfertat të Kushtëzuara.

Investime të financuara nga vetë bashkitë në milionë lekë për vitin 2016.






Tabela nr. 2.: Shpenzimet për frymë për investime dhe rritja vjetore e investimeve në vitin 2016.

	Popullsia, Census 2011	2012	2013	2014	2015	2016	Rritja vjetore
Kolonjë	11,070	577	985	876	18	1,930	10669%
Këlcyrë	6,113	760	688	1,463	282	7,055	2401%
Tepelenë	8,949	1,591	1,603	4,095	380	8,672	2183%
Malësi e Madhe	30,823	804	918	1,198	485	5,991	1136%
Maliq	41,757	542	703	1,554	418	3,217	670%
Fushë Arrëz	7,405	2,167	1,796	1,383	517	3,300	539%
Gramsh	24,231	2,070	1,467	949	363	2,202	506%
Ura Vajqurore	27,295	742	1,514	1,983	510	3,068	502%
Konispol	8,245	5,341	4,660	7,902	448	2,301	414%
Tropojë	20,517	2,033	2,373	3,563	1,477	7,135	383%
Roskovec	21,742	917	1,552	3,670	2,510	9,740	288%
Fier	120,655	1,402	899	1,036	667	2,406	261%
Peqin	26,136	3,205	875	5,471	648	2,328	259%
Rrogozhinë	22,148	2,295	2,050	2,394	947	3,111	229%
Libohovë	3,667	984	1,689	1,943	2,062	6,171	199%
Dibër	61,619	578	643	1,607	1,437	3,863	169%
Delvinë	7,598	436	210	394	1,167	3,037	160%
Has	16,790	6,558	3,231	5,745	1,568	3,561	127%
Poliçan	10,953	3,865	3,687	2,954	1,576	3,527	124%
Pogradec	61,530	2,345	2,479	2,711	571	1,254	120%
Kukës	47,985	497	334	648	578	1,115	93%
Devoll	26,716	1,633	840	1,065	1,202	2,314	92%
Prrenjas	24,906	342	539	5,246	484	886	83%
Belsh	19,503	885	3,439	1,485	1,462	2,627	80%
Pustec	3,290	1,509	840	729	1,304	2,260	73%
Berat	60,031	1,375	1,790	1,976	1,762	2,965	68%
Finiq	10,529	667	668	391	1,248	2,087	67%
Cërrik	27,445	617	759	1,373	1,187	1,878	58%
Tiranë	557,422	630	1,691	1,280	5,062	7,962	57%
Bulqizë	31,210	1,773	1,016	1,745	2,091	3,268	56%
Vau Dejës	30,438	512	296	2,890	2,152	3,277	52%
Vlorë	104,827	990	809	1,161	639	914	43%
Vorë	25,511	455	981	720	5,933	7,998	35%
Selenicë	16,396	1,391	1,545	2,732	3,081	4,095	33%
Lushnjë	83,659	720	550	1,506	1,186	1,542	30%
Dropulli	3,503	1,072	3,162	4,636	4,807	6,222	29%
Klos	16,618	1,683	410	1,603	1,796	2,318	29%
Pukë	11,069	392	185	1,586	1,542	1,924	25%
Librazhd	31,892	2,470	1,452	1,731	1,192	1,394	17%
Divjakë	34,254	4,504	5,566	4,360	2,333	2,471	6%
Gjirokastër	28,673	473	1,818	1,131	2,334	2,361	1%
Kamëz	104,190	451	654	1,202	3,317	3,355	1%
Mallakaster	27,062	397	271	419	2,545	2,537	0%
Patos	22,959	439	2,014	2,326	3,326	3,250	-2%
Krujë	59,814	729	641	685	2,081	1,993	-4%
Mat	27,600	1,913	1,979	1,783	2,189	2,000	-9%
Skrapar	12,403	737	1,236	1,170	7,558	6,582	-13%
Himarë	7,818	4,146	4,001	6,365	6,555	5,207	-21%
Kuçovë	31,262	950	1,254	1,145	2,684	2,089	-22%
Kavajë	40,094	4,279	5,666	5,448	5,425	4,060	-25%
Mirditë	22,103	6,639	3,544	3,223	5,099	3,755	-26%
Përmet	10,614	3,348	2,383	3,794	998	734	-26%
Korçë	75,994	1,060	1,604	1,589	2,920	1,872	-36%
Lezhë	65,633	2,220	5,781	1,435	2,798	1,672	-40%
Durrës	175,110	608	199	3,914	6,408	3,428	-47%
Kurbin	46,291	2,676	4,194	4,103	1,265	652	-48%
Memaliaj	10,657	983	4,347	1,985	3,078	1,511	-51%
Sarandë	20,227	271	368	1,890	4,653	2,260	-51%
Elbasan	141,714	975	2,039	2,267	3,074	1,450	-53%
Shkodër	135,612	2,111	1,211	1,685	1,196	516	-57%
Shijak	27,861	4,570	7,955	4,972	7,398	3,032	-59%

# www.financatvendore.al



## **Në Platformën [www.financatvendore.al](http://www.financatvendore.al) mund të njiheni me:**

- Të dhëna financiare në formë tabelare, grafike dhe hartografike për të gjitha njësitë vendore për periudhën 2008-2016
  - Raporte Analitike mbi Financat Vendore - Tremujorë dhe Vjetorë
  - Baza Ligjore në lidhje me Financat Vendore
  - Buxhetet dhe Paketat Fiskale të Bashkive
  - Artikuj me interes në fushën e Financave Vendore
- Gjithashtu ju mund të ndërtoni analizën tuaj, duke gjeneruar krahasime të treguesëve ndër vite apo ndërmjet bashkive.